



UNIVERSITETI I PRISHTINËS UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 4140
Datë: 21.11.2025

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës, bazuar në dispozitat e nenit 14 të Statutit të UP-së, si dhe në dispozitat e nenit 19, pika 8, nenit 28, pika 1, nënpika 1.2, të Rregullores së punës nr. 280, të datës 13.2.2025, në mbledhjen e mbajtur më 06.11.2025, mori vendim të shpallë:

KONKURS

Për ndarjen e bursave universitare për studentët e studimeve master për vitin akademik 2025/26

I. Kushtet e përgjithshme

1. Bursat universitare ndahen për studentët e nivelit të studimeve master, shuma vjetore e bursës do të jetë në vlerë: 700 euro.
2. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët e regjistruar në vitin 2024/25 që i plotësojnë këto kushte:
 - 2.1. Të jenë studentë të rregullt të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës;
 - 2.2. Të mos kenë vit të përsëritur të studimeve;
 - 2.3. Të kenë të regjistruar semestrin dimëror 2025/26;
 - 2.4. T'i kenë dhënë të gjitha provimet e parapara për vitin përkatës të studimeve në afatin e shtatorit të vitit akademik 2024/25;
 - 2.5. Të kenë notë mesatare të përgjithshme jo më të ulët se 9.00 (nëntë pikë zero).
3. Studentëve që nuk i plotësojnë kriteret e mësipërme, shërbimi i studentëve në njësinë akademike përkatëse nuk do t'ua verifikojë në SEMS fletëparaqitjen, e cila ua mundëson aplikimin për bursë.

II. Dokumentacioni i nevojshëm për aplikim

1. Studentët që i plotësojnë kushtet nga pika I e këtij konkursi, aplikimin duhet ta bëjnë përmes platformës elektronike SEMS, në linkun: sems.uni-pr.edu
2. Dokumentet e nevojshme për aplikim janë:
 - 2.1. Kërkesa për aplikim (Fletë aplikacioni), e cila shkarkohet pas aplikimit online përmes SEMS-it.
3. Studenti është i obliguar që fletën e aplikacionit ta printojë dhe ta dorëzojë në shërbimin e studentëve të fakultetit përkatës, si dëshmi që ka aplikuar brenda afatit të paraparë të konkursit.
4. Fakultetet janë të obliguara që, në përputhje me kriteret e përcaktuara në këtë konkurs, t'i përgatisin listat e studentëve që i plotësojnë kriteret për fitimin e bursës universitare, për miratim nga Këshilli Drejtues i UP-së.

5. Përgjegjësinë për saktësinë e të dhënave e bartin dekanët e njësive akademike.
6. Bursat universitare për vitin akademik 2025/26 ndahen për rezultatet e arritura në vitin akademik 2024/25.
7. Nëse gjatë aplikimit paraqiten probleme eventuale teknike, studentët duhet të paraqesin kërkesë për ndihmë në SEMS, te pjesa Kërkesa/Ankesa, duke përshkruar problemin që u shfaqet.

III. Afati i aplikimit

1. Aplikimi në linkun sems.uni-pr.edu hapet nga data **21.11.2025** në ora **10:00** dhe përfundon me datë **26.11.2025, në ora 16:00**.

IV. Afati i ankesave

1. Studentët që konsiderojnë se kanë pasur të drejtë përfitimi të bursës universitare dhe nuk janë përfshirë në listën e përfituesve kanë të drejtë ankesë brenda **48 orëve** pas ditës së publikimit të listave.
2. Ankesat dorëzohen në **zyrën e arkivit të UP-së (nr. 18)**, në ndërtesën e Rektoratit të UP-së.
3. Ankesat e dorëzuara pas afatit **nuk do të merren në shqyrtim**.

V. Publikimi

Vendimi do të publikohet në tabelat e shpalljeve dhe faqet zyrtare të fakulteteve, si dhe në faqen zyrtare të Universitetit të Prishtinës: www.uni-pr.edu.



